



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:064590
Datë: 20.12.2024
Numri i dokumentit: 06635209

CA.nr.7596/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Ardian Ajvazi dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.Sh. nga fsh. B. Komuna K., kundër të paditurit Q.T. nga fsh. B. Komuna Kaçanik, për pengim posedimi, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, C.nr.2023:138849 i datës 19.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurit Q.T. nga fsh. B. Komuna Kaçanik, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, C.nr.2023:138849 i datës 19.06.2024 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.2023:138849 të datës 19.06.2024, ka vendosur si në vijim:

“I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.Sh. nga fshati B. – Komuna e Kaçanikut kundër të paditurit Q.T. nga fshati B. – Komuna e Kaçanikut dhe VËRTETOHET se i padituri Q.T. ka penguar paditësin N.Sh. në posedimin e parcelës 1018-1 dhe atë në një sipërfaqe prej 10 m², parcelës 1018-2, në një sipërfaqe prej 23m², dhe parcelën 1019-3, në një sipërfaqe prej 1m², ne ZK B. duke e kthyer gjendejn e mëparshme para aktit të pengimit rrespektivisht para datës 28.03.2022.

II. DETYROHET i padituri që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi që ta zhvendos-rrënoj murin ne pjesën ku është kryer pengim posedimi dhe në të

ardhmen të përmbahet nga çfarëdo veprimi në drejtim të dëmtimit, shqetësimit apo ndërhyrjes në posedim të ngastrës kadastrale dhe atë në sipërfaqe prej prej 10 m² në parcelën 1018-1, në sipërfaqe prej 23m² në parcelën 1018-2 dhe në sipërfaqe prej 1m² ne parcelën 1019-3-, e cila sipërfaqe deri në momentin e pengimit ka qenë në posedim të paditësit N.Sh. dhe këto pjesë të parcelave duhet të kthehen në posedim të paditësit, pa prejjudikuar bazën juridike të pronësisë

III. DETYROHET pala e paditur që paditësit të ia paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 524.00€, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.”

Kundër këtij aktvendimi i padituri, përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovoj ankesën e të paditurit në tërësi si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i ankimuar ose të priset aktvendimi i ankimuar dhe lënda të kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimit e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 01.04.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurit, për pengim posedimi, duke theksuar se i padituri pa lejen e tij si posedues i njësisë kadastrale me numër 1017-1, ka bërë ndërtimin e murit me çka ka penguar paditësin në shfrytëzimin – posedimin e qetë të pronës së tij, duke i propozuar gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta miratoj në tërësi si të bazuar dhe të vërtetohet se i padituri, e ka penguar paditësin në posedimin dhe shfrytëzimin e qetë të pronës së tij, me rastin e ndërtimit të murit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të provave dhe të gjitha shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktvendimin C.nr.2022:064591 të datës 30.03.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.2662/2023 të datës 05.06.2023, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Pas kthimit në rishqyrtim dhe rivendosje, gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin C.nr.2023:138849 të datës 19.06.2024, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka thekuar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar se, pala paditëse brenda afateve ligjore ka paraqitur padi për pengim posedimi, konkretisht pala paditëse ka marr dijeni mbi pengim posedimin me datë 28.03.2022, ndërsa ka paraqitur padi me datë 01.04.2022 konform nenit 114 të Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore. Gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi pasi ka konsideruar se thëniet dhe pretendimet e palës paditëse në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe provat e paraqitura dëshmojnë gjendjen e fundit dhe atë se i padituri përmes veprimeve të ndërmarra ka shqetësuar - penguar në posedim paditësin Nuhi Shehu, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së parë e ka detyruar palën e paditur që të ndërmer veprime që të zhvendos rrënoj murin ne pjesën ku është kryer pengim posedimi dhe në të ardhmen të përmbahet nga çfarëdo veprimi në drejtim të dëmtimit, shqetësimit apo ndërhyrjes në posedim të ngastrës kadastrale parcelës 1018-1 dhe atë në një sipërfaqe prej 10 m², parcelës 1018-2, në një sipërfaqe prej 23m², dhe parcelën 1019-3, në një sipërfaqe prej 1m², ne ZK B., kjo me qëllim që paditësi të lirohet nga pengesa e paraqitur nga i padituri dhe të rivendosjes së posedimit, dhe që poseduesi N.Sh. të jetë i lirë në të ardhmen në posedim të pronës së paluajtshme, të gjitha këto konform nenit 113 paragrafi 2 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore *“Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore.”* andaj edhe gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me tutje ka theksuar se, Gjykata i ka analizuar theksimet dhe pretendimet e palës paditëse se pala e paditur ka ndërmarr veprime me të cilat është penguar posedimi i pronës së paluajtshme, këtyre pretendimeve gjykata ua fali besimin andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, gjithashtu i ka analizuar me vëmendje të shtuar pretendimet e palës së paditur të cilat kryesisht kishin të bënin me faktin se i padituri e ka ndërtuar murin pasi që ka kërkuar ndihmën e një eksperti të gjeodezisë për vendosjen e pikave kadastrale dhe pas kësaj ka bërë ndërtimin e murit në tokën e vet dhe në parcelën e vet brenda vijave kadastrale, mirëpo këto theksime nuk i referoheshin objektit të kontestit e që në rastin konkret objekt kontesti është çështja e pengimit në posedim, prandaj pretendimet e tilla për gjykatën janë të pa bazuara dhe si të tilla nuk u morën për bazë.

Gjykata e Apelit vlerëson se, aktvendimi i ankimuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë për shkelje nga neni 182 par.1 e 2 pika n), e lidhur me nenin 160.4 të LPK-së dhe si pasojë e kësaj, nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike dhe gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale.

Gjykata e Apelit vlerëson se, qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se aktvendimi është marr me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së, sepse dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyetimin, aktvendimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, po ashtu dispozitivi i aktvendimit është i

pakuftueshëm, i paqartë, i papërmbarueshëm, kontradiktor me vetvete dhe me thënie në arsyet e aktvendimit dhe arsyetimet e dhëna janë plotësisht të paqarta dhe kontradiktore.

Sipas kësaj gjykate, aktvendimi i ankimuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vërtetuar se, i padituri e ka penguar paditësin në posedimin e parcelës 1018-1 dhe atë në një sipërfaqe prej 10 m², parcelës 1018-2, në një sipërfaqe prej 23m², dhe parcelën 1019-3, në një sipërfaqe prej 1m², ne ZK B. duke e kthyer gjendjen e mëparshme para aktit të pengimit respektivisht para datës 28.03.2022, pa shënuar saktë se cili është veprimi i të paditurit që ka penguar paditësin, mënyra se si është vendosur nga gjykata e shkallës së parë është e paqartë, vendimi është i paekzekutueshëm, sepse nuk janë të specifikuara respektivisht nuk janë specifikuar përkufizimet e pjesëve të ngastrave për të cilat pretendon paditësi se e ka penguar i padituri.

Qëndrojnë pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës edhe sa i përketë ndalimit të paditurit për ti parashtruar pyetje dëshmitarit Fadil Shehu, dëshmitar i propozuar nga ana e paditësit, sipas procesverbalit të datës 29.11.2023.

Me dispozitën e nenit 289.2 të LPK-së është paraparë që: *“Nëse pjesëmarrësi në procedurë apo personi që është i pranishëm në vendin ku mbahet seanca për shqyrtimin e çështjes e fyen gjykatën, apo pjesëmarrësit tjerë në procedurë, e pengojnë punën apo nuk i respektojnë urdhrat e gjyqtarit për mbajtjen e rendit dhe qetësisë, gjykata do ta qortojë atë. Nëse qortimi tregohet i pasuksesshëm, gjykata personin e qortuar do ta largojë nga vendi ku mbahet seanca gjyqësore ose do ta dënojë me gjobë deri në 500 €, kurse mund edhe ta largojë edhe ta dënojë me gjobë”,* në rastin konkret gjykata ka pasur mundësi që nëse i njëjti e ka fyer gjykatën apo palën tjetër e kurrsesi të ia ndalojë që i njëjti t’i bëjë pyetje dëshmitarit të propozuar. Po ashtu gjykata e shkallës së parë nuk iu ka përmbajtur në tersi vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit sipas aktvendimit Ac.nr.2662/2023 të datës 05.06.2023, e cila ka pasur për obligim konform nenit 199 të LPK-së.

Për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të cekura më lartë, gabimisht është konstatuar edhe gjendja faktike dhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, për të cilat kjo Gjykatë nuk do të lëshohet më tutje në lidhje me bazat tjera për arsye se tani për tani aktvendimi nuk mund të ekzaminohet për shkak të shkeljeve që e bëjnë të pa qëndrueshëm, jo të drejtë dhe të ligjshëm, për këtë arsye Aktvendimi i ankimuar është dashur të anulohet dhe çështja të kthehet në riprocedurë dhe rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë udhëzohet që të eliminojë shkeljet e lartcekura, ashtu që fillimisht të vërtetoj faktin se kur ka ndodhur pengim posedimi, datën e pengim posedimit, cili është veprimi i të paditurit drejtuar paditësit që ka shkaktuar aktin e pengim posedimit si elemente qenësore në mënyrë që të vlerësohet pengim posedimi, respektivisht veprimet e të paditurit drejtuar paditësit që mund të rezultojnë në pengimin e posedimit të qetë dhe të lirë të pronës së tij, pastaj të qartësohen pjesët e ngastrave lëndore për të cilat pretendon paditësi që i

padituri e ka kryer aktin e pengim posedimit, me të gjitha përkufizimet me dimensione të sakta, sipërfaqen, vendin se ku gjenden këto ngastra, e duke pasur parasysh edhe pretendimet e të paditurit, me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të palës paditëse, e pas një vlerësimi të drejtë dhe të plotë, të merr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm, i cili në pikëpamje formale dhe materiale të jetë i strukturuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Meqenëse aktvendimi i ankimuar është anuluar, edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është dashur të anulohet, për shkak se gjatë procedurës së rigjykimi mund të krijohen shpenzimet tjera eventuale dhe varësisht prej kësaj gjykata e shkallës së parë do të vendosë për shpenzimet e gjithmbarshme procedurale varësisht prej suksesit të palës në procesin gjyqësor, kur të vendosë me vendim përfundimtar, e në pajtim me nenin 465.3 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, e në kuptim të nenit 209 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.7596/24, me datë 09.12.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.